

International Marketing Solutions sh. p. k.

**Pasqyrat Financiare Individuale
për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Emërtimi dhe forma ligjore: **International Marketing Solutions.**
NUIS: **L71312043D**
Adresa e selisë: **Rr. Ismail Qemali, Pallati nr. 22, Ap. 4, Tiranë**
Data e krijimit: **12.01.2017**
Veprimtaria kryesore: Ofrimi i shërbimeve të marketingut online, marketingu digjital, shërbime të konsulencës tregtare, informatike, shërbime lidhur me publikimin dhe reklamimin në ueb, shërbime "Call Center" apo "Contact Center" në fushën e telemarketingut apo teleselling, etj..

**PASQYRAT FINANCIARE INDIVIDUALE
PËR PERIUDHËN E MBYLLYR MË 31 DHJETOR 2017**

Pasqyrat Financiare janë individuale:	Po
Pasqyrat Financiare janë të konsoliduara:	Jo
Pasqyrat Financiare janë të shprehura në:	Lekë
Pasqyrat Financiare janë të rrumbullakosura në:	Lekë
Periudha kontabël e Pasqyrave Financiare:	Nga 12.01.2017 deri më 31.12.2017
Data e mbylljes së Pasqyrave Financiare:	15.03.2018



Përmbajtja:

	Faqe
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017	3
Pasqyra e performancës dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017	4
Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017	5
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017	6
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	7 - 15



International Marketing Solutions sh. p. k.

Pasqyra e pozicionit financiar
më 31 dhjetor 2017

(shumat në Lek)

	Shënime	31 dhjetor 2017
Aktivitet		
I. Aktivitet afatshkurtra		
Mjete monetare	4	705,809
Të drejta të arkëtueshme	5	661,543
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,367,352
Aktivitet afatgjata		
Të drejta të arkëtueshme afatgjata	6	212,720
Aktive materiale	7	166,528
Aktive jomateriale		-
Totali i aktiveve afatgjata		379,248
Totali i aktiveve		1,746,600
Detyrime dhe kapitali		
Detyrime afatshkurtra		
Detyrime afatshkurtra	8	5,586,057
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	9	9,296
Totali i detyrimeve afatshkurtra		5,595,353
Detyrime afatgjata		
Detyrime të tjera afatgjata		-
Totali i detyrimeve afatgjata		-
Totali i detyrimeve		5,595,353
Kapitali dhe rezervat		
Kapitali i nënshkruar	1	100,000
Fitimi (humbja) i pashpërndarë		-
Fitimi (humbja) i vitit		(3,948,753)
Totali i kapitalit		(3,848,753)
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		1,746,600



Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 – 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017 u aprovuan nga International Marketing Solutions sh.p.k. dhe u nënshkruan si më poshtë më 15 mars 2018.

Ganion Arapi
Administrator



Brunila Leskaj
Kontabël i Miratuar
HM&H Business Sh.p.k.



International Marketing Solutions sh. p. k.

Pasqyra e performancës dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse
për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në Lek)

	Shënime	Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit:		
Të ardhurat nga shitja	10	39,063,821
Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		-
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		-
Totali i të ardhurave nga aktiviteti i shfrytëzimit		39,063,821
Shpenzimet:		
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		-
Shpenzime të personelit:	11	-
Paga dhe shpërblime		(31,452,749)
Shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore		(4,794,412)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	7	(27,904)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	12	(6,748,994)
Totali i shpenzimeve		(43,024,058)
Të ardhura të tjera		-
Zhvlerësimi i aktiveve dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra		-
Të ardhurat dhe shpenzime financiare:		
Të ardhura (shpenzime) nga interesat dhe të ngjashme, neto	13	131
Të ardhura (shpenzime) nga kursi i këmbimit, neto	14	11,353
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare		11,484
Pjesa e fitimit (humbjes) nga pjesëmarrjet		-
Fitimi (humbja) para tatimit		(3,948,753)
Shpenzimi për tatimin mbi fitimin aktual	15	-
Të ardhura nga tatimet e shtyra	15	-
Fitimi (humbja) e vitit		(3,948,753)
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse		
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		
Diferencat nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja		-
Diferencat nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		-
Diferencat nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje		-
Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet		-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		(3,948,753)

Pasqyra e performancës dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 – 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

International Marketing Solutions sh. p. k.

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për periudhën e mbylltur më 31 dhjetor 2017

(shumat në Lek)

	Kapitali aksionar	Fitime (humbje) të akumuluar	Totali
Pozicioni më 12 janar 2017	100,000	-	100,000
Të ardhura (humbje) gjithëpërfshirëse për vitin:			
Fitimi (humbja) e vitit	-	(3,948,753)	(3,948,753)
Të ardhura (humbje) të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-
Të ardhura (humbje) totale gjithëpërfshirëse për vitin	-	(3,948,753)	(3,948,753)
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:			
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	-	-	-
Dividendë të paguar	-	-	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	-	-	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	100,000	(3,948,753)	(3,848,753)

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 – 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

International Marketing Solutions sh. p. k.

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në Lek)

	Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Fluksi monetar nga (përdorur në) veprimtaritë e shfrytëzimit	
Fitimi (humbja) e vitit	(3,948,753)
Rregullime për shpenzimet jomonetare:	
Shpezime konsumi dhe amortizimi	27,904
Shpenzime të konstatuara	9,296
Shpenzimet (te ardhurat) nga interesi, neto	(131)
Shpenzimet financiare jomonetare	(21,773)
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:	
Rënie (Rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(878,423)
Rënie (Rritje) në inventarë	-
Rritje (rënie) në detyrimet e pagueshme	4,147,767
Rritje (rënie) në detyrimet për punonjësit	-
Interesa të arkëtuar	131
Interesa të paguar	-
Pagesa për tatimin mbi fitimin	-
Mjete monetare neto nga (përdorur në) veprimtaritë e shfrytëzimit	(663,981)
Fluksi i mjeteve monetare nga (përdorur në) aktivitetin e investimit	
Pagesa për blerjen e aktiveve materiale	(194,432)
Mjete monetare neto nga (përdorur në) veprimtaritë e investimit	(194,432)
Fluksi i mjeteve monetare nga (përdorur në) aktivitetin e financimit	
Financime nga ortakët	1,468,062
Pagesa për kapitalin e nënshkruar	100,000
Mjete monetare neto nga (përdorur në) veprimtaritë e financimit	1,568,062
Rritje (rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë mjeteve monetare	709,649
Mjete monetare dhe ekuivalentë mjeteve monetare më 1 janar	-
Efekti i luhatjeve të kurseve të këmbimit të mjeteve monetare	(3,840)
Mjete monetare dhe ekuivalentë mjeteve monetare më 31 dhjetor	705,809

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



International Marketing Solutions sh. p. k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

International Marketing Solutions (këtu referuar si "IMS" ose "Shoqëria") është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar me Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) më datë 12 janar 2017.

Aktiviteti i Shoqërisë konsiston në ofrimin e shërbimeve të marketingut online, marketingut digjital si dhe kryerjen e shërbimeve të konsulencës dhe organizimit tregtar të subjekteve tregtare, apo dhe konsulencës teknologjike për implementimin e sistemeve telematike dhe informatike në sektorët e informatikës dhe tregtisë, tregtimin e shërbimeve të lidhura me publikimin dhe reklamimin e të dhënave në ueb për subjektet tregtare, aktivite tregtare në lidhje me pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe financiare të lidhura me objektin e veprimtarisë së kësaj shoqërie, ofrimin e të gjitha shërbimeve që lidhen me "Call Center" dhe "Contact Center" në fushën e telemarketingut apo teleselling duke përfshirë edhe përpunimin e të dhënave të shoqërive të tjera dhe/ose enteve publike, etj..

Shoqëria është e regjistruar me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë me NUIS L71312043D.

Kapitali i regjistruar dhe i paguar i IMS është 100,000 Lek. Ortaku i vetëm i Shoqërisë është Z. Ganion Arapi.

Përfaqësi ligjor i Shoqërisë është Z. Ganion Arapi.

Adresa e Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 është Rr. Ismail Qemali, Pallati nr. 22, Ap. 4, Tiranë.

Numri i të punësuarve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 është 52.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, të përmirësuara (SKK), të cilat janë të aplikueshme në mënyre prospektive duke filluar nga data 1 janar 2015.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike. Bazat e matjes për çdo aktiv, detyrim, të ardhur dhe shpenzim janë përshkruar në detaje në shënimet shpjeguese në vijim.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrjnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyre të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke pasur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat të paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet dhe balancat në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të

International Marketing Solutions sh. p. k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jomonetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse

Zërat jomonetare të cilat përlogariten me kosto historike në monedhë të huaj, konvertohen duke përdorur kurset e këmbimit të datave të transaksionit fillestar. Zërat jomonetare të cilat njihen me vlerën e drejtë, në monedhë të huaj, konvertohen duke përdorur kurset e këmbimit në datën kur përcaktohet vlera e drejtë. Humbja ose fitimi që rezulton nga konvertimi i zërave jomonetare trajtohet në të njëjtën mënyrë si njohja e humbjes ose fitimit nga ndryshimi i vlerës së drejtë të zërave të pasqyrës së pozicionit financiar (p.sh. diferencat e konvertimit në zëra të cilave u njihet humbja ose fitimi në pasqyrën e performancës).

	<u>31 Dhjetor 2017</u>
1 EUR	132.95
1 USD	111.10

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme. Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentet e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentet financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me bankat si dhe investime të tjera afatshkurtra shumë likuide me maturim origjinal tre ose më pak muaj, të cilat janë objekt rreziku jo domethënës ndaj ndryshimeve në vlerë dhe që përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e detyrimeve të saj afatshkurtra.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e drejtë, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

International Marketing Solutions sh. p. k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

3.3 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen me blerjen e aktivitetit si dhe kosto të tjera direkte që lidhen me sjelljen e aktivitetit në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendje e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në koston e aktivitetit nuk përfshihen koston e huamarrjes të cilat njihen si shpenzime në momentin kur ato ndodhin.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në të ardhura të tjera në pasqyrën e performancës.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit, mbi jetën e dobishme të vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Metodat dhe përqindjet e amortizimit për secilën kategori aktivesh afatgjata për periudhën aktuale janë si më poshtë:

Përmirësim në qiramarrje	Mbi vlerën kontabël neto	5%
Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje zyrash dhe informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Të tjera pajisje	Mbi vlerën kontabël neto	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Zhvlerësimi

(i) Aktivitetet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohen të burojnë nga aktiviteti.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivitetin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

International Marketing Solutions sh. p. k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuara, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

(ii) Aktivët jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

3.5 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet llogarisë fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin aktual të periudhës si dhe tatimin e shtyrë. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen drejtpërdrejt në pasqyrë e performancës përveç rasteve kur këto lidhen me zëra që njihen direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Kompensimi midis aktiveve tatimore aktuale dhe detyrimeve tatimore aktuale ose midis aktiveve tatimore të shtyra dhe detyrimeve tatimore të shtyra kryhet vetëm nëse ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar këto shuma ose kur do të paguhet shuma neto e tyre apo do të realizohen aktivet dhe do të shlyhen detyrimet në të njëjtën kohë.

Tatimi aktual

Tatimi aktual është përlllogaritje e tatimit mbi fitimin të pagueshëm në lidhje me fitimin e tatueshëm të periudhës kontabël aktuale duke përdorur normën e tatimit në fuqi në datën e raportimit si dhe sistemit në lidhje me tatimin e pagueshëm për periudha të shkuara.

Aktivët dhe pasivet tatimore përlllogariten në vlerën e pritshme që do të kompensohet ose do t'u paguhet autoriteteve tatimore. Për llogaritjen e vlerave u bëhet referencë normës tatimore dhe legjislacionin tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë në datën e raportimit. Fitimi i tatueshëm i periudhës ndryshon nga fitimi neto i paraqitur në pasqyrën e performancës si pasojë e rregullimeve në zërat e ardhurave ose shpenzimeve të cilat janë tatuar apo njohur si të zbritshme në periudha të tjera si dhe zërave të cilët nuk janë të tatueshëm apo të zbritshëm bazuar në legjislacionin tatimor në fuqi.

International Marketing Solutions sh. p. k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Drejtimi i shoqërisë në mënyre periodike vlerëson qëndrimet e mbajtura në përgatitjen e deklaratave tatimore për ato raste në të cilat parashikimet e legjislacionit tatimor në fuqi janë subjekt i interpretimeve nga ana e organeve tatimore shqiptare dhe krijon provizione aty ku është e përshtatshme.

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet si pasojë e diferencave të përkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme, humbjet tatimore dhe kreditimet tatimore të papërdorura, për aq sa ato ka mundësi të mbulohen nga përfitimet e ardhshme tatimore. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri në masën që ka mundësi që të realizohet përfitimi tatimor. Aktivet tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në atë vlerë që do të jetë e mundur për të mbuluar aktivet tatimore të shtyra me fitimin e tatueshëm të viteve të ardhshme.

Aktivi apo detyrimi tatimor i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme të lidhura me:

- njohjen e emrit të mirë;
- fitimet e papaguara nga investimet në filialet e huaja, degët, pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta në masën që investimi është i përhershëm në kohëzgjatje përveçse kur është e dukshme që diferencat e përkohshme do të rimerren në të ardhmen e parashikueshme.

Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra përllogariten sipas normës tatimore në fuqi në datën e raportimit.

4. Mjetet monetare

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2017 janë përbërë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Llogari rrjedhëse:	
Në Lek	38,728
Në Euro	403,461
Në Dollar Amerikan	787
	<u>442,975</u>
Arka:	
Arka në Lek	35,990
Arka në Euro	217,956
Arka në Dollar Amerikan	8,888
	<u>262,834</u>
TOTALI	<u>705,809</u>

5. Të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 janë përbërë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Të arkëtueshme nga klientët	265,902
TVSH për t'u marrë	395,641
TOTALI	<u>661,543</u>

International Marketing Solutions sh. p. k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

6. Të drejta të arkëtueshme afatgjata

Të drejtat e arkëtueshme afatgjata më 31 dhjetor 2017 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Garanci për qira	212,720
TOTALI	<u>212,720</u>

7. Aktivet afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2017 janë përbërë si më poshtë:

	Mobilje dhe orendi	Kompjuterë dhe pajisje informatike	Përmirësim në Qiramarrje	Të tjera pajisje	Totali
Kosto					
Më 12 janar 2017	-	-	-	-	-
Shtesa	-	32,000	-	162,432	194,432
Më 31 dhjetor 2017	-	32,000	-	162,432	194,432
Amortizimi i akumuluar					
Më 12 janar 2017	-	-	-	-	-
Shuma për vitin	-	4,495	-	23,409	27,904
Më 31 dhjetor 2017	-	4,495	-	23,409	27,904
Vlera e mbetur					
Më 12 janar 2017	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2017	-	27,505	-	139,023	166,528

8. Detyrime afatshkurtra

Detyrimet afatshkurtra më 31 dhjetor 2017 janë përbërë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Të pagueshme ndaj furnitorëve	120,374
Paradhënie nga ortaku	1,468,062
Detyrime ndaj personelit	2,847,913
Detyrime tatimore:	
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	820,892
Tatim mbi të ardhurat personale	296,483
Të tjera tatime dhe taksa	32,333
TOTALI	<u>5,586,057</u>

9. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Të pagueshmet për shpenzime të konstatuara më 31 dhjetor 2017 në vlerën 9,296 Lek lidhen me shpenzime të realizuara në datën e raportimit por për të cilat ende nuk ka mbërritur fatura përkatëse. Këto shpenzime kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime telefonie celulare.

10. Të ardhurat nga shitja

Të ardhurat nga shitja për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017 përbëhen si më poshtë:

	<u>Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Të ardhura nga shërbimet	39,063,821
TOTALI	<u>39,063,821</u>

International Marketing Solutions sh. p. k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

11. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit për periudhën e mbyllur 2017 përbëhen nga pagat dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

	Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Pagat dhe shpërblime	31,452,749
Shpenzime të sigurime shoqërore dhe shëndetësore	4,794,412
TOTALI	36,247,161

12. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017 përbëhen si më poshtë:

	Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime për aktivitetin	211,530
Shpenzime për qira zyre	3,211,764
Shpenzime për rrjetin (network)	1,047,285
Shpenzime për reklama dhe publicitet	231,486
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	73,067
Shpenzime interneti	508,745
Shpenzime për shërbime bankare	124,581
Shpenzime të ndryshme për zyrë	496,292
Shpenzime noteriale	3,700
Shpenzime kancelarie	8,056
Taksa dhe tarifa vendore	89,333
Penalitete, gjoba dhe dëmshpërblime	107,361
Shpenzime për shërbime kontabël dhe fiskale	635,794
TOTALI	6,748,994

13. Të ardhura (shpenzime) nga interesat dhe të ngjashme, neto

Të ardhurat (shpenzimet) nga interesat dhe të ngjashme, neto për periudhën e mbyllur 2017 përbëhen si më poshtë:

	Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga interesi nga llogaritë rrjedhëse	131
Shpenzime interesi nga llogaritë rrjedhëse	-
TOTALI	131

14. Të ardhura (shpenzime) nga kursi i këmbimit, neto

Të ardhurat (shpenzimet) nga kursi i këmbimit, neto për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017 përbëhen si më poshtë:

	Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Fitime të realizuara nga kursi i këmbimit	76,387
Fitime të porealizuara nga kursi i këmbimit	49,760
	126,147
Humbje të realizuara nga kursi i këmbimit	(100,425)
Humbje të porealizuara nga kursi i këmbimit	(14,369)
	(114,794)
TOTALI	11,353



International Marketing Solutions sh. p. k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

15. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15% për vitin 2017.

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

(i) Shpenzimi i tatimit mbi fitimin aktual

Për vitin 2017 Shoqëria ka rezultuar me humbje kontabël dhe me humbje tatimore si më poshtë

	<u>Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Fitimi fiskal / (Humbja) fiskale e periudhës (përfundon në 2021)	(3,335,804)
Humbje të mbartura:	
Humbje të mbartura nga periudha të mëparshme	-
Fshirje e humbjeve pa të drejtë mbartje	-
TOTALI	<u>(3,335,804)</u>

Bazuar në legjislacionin tatimor shqiptar, Shoqëria ka të drejtë të mbartë humbjet tatimore për një periudhë tre vjeçare. Në rast se gjatë një periudhe pronësia e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e kapitalit të shoqërisë apo të drejtave të votës ndryshon me më shumë se 50%, atëherë e drejta e mbartjes së humbjeve të realizuara nga shoqëria në periudhën tatimore kur ndodh ndryshimi, si dhe në periudhat paraardhëse, nuk zbatohet.

Humbja tatimore e përllogaritur nga ana e Shoqërisë për vitin 2017 është 3,335,804 Lek.

Rikoncilimi i normës efektive të tatimit:

	<u>2017</u>	<u>%</u>
Fitimi/ humbja e periudhës para tatimit	(3,948,753)	100.00%
Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde	(592,313)	15.00%
<i>Rregullime për diferencë të përkohshme:</i>		
Shpenzime të konstatuara	1,394	-0.04%
Të ardhura nga rimarrja e shpenzimeve të konstatuara	-	0.00%
<i>Zëra shpenzimesh të panjohura:</i>		
Gjoha dhe penalite	16,104	-0.41%
Të tjera shpenzime të panjohura	74,444	-1.89%
TOTALI	<u>(500,371)</u>	<u>12.67%</u>

(ii) E ardhura (shpenzimi) nga tatimet e shtyra

Tabelat në vijim paraqesin llogaritjet në lidhje me tatimin e shtyrë për periudhën e mbyllura më 31 dhjetor 2017. Shoqëria ka zgjedhur të mos njohë aktivin tatimor të shtyrë pasi disponueshmëria e fitimeve të tatueshme për vitet vijuese nuk është e sigurtë.

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Aktive tatimore të shtyra	-
Detyrime tatimore të shtyra	-
Totali	<u>667,369</u>

Lëvizjet në llogarinë e tatimit të shtyrë paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Në fillim të periudhës	-
E ardhura (shpenzimi) nga tatimi i shtyrë mbi fitimin	667,369
Në fund të periudhës	667,369
Tatimi i shtyrë i panjohur	(667,369)
Balanca e mbylljes	<u>-</u>

International Marketing Solutions sh. p. k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Më 31 dhjetor 2017 aktivet dhe detyrimet tatimore të shtyra paraqiten si më poshtë:

Aktivi tatimor i shtyrë	Humbja tatimore	Shpenzime të konstatuara	Totali
Më 12 janar 2017	-	-	-
E ardhura (shpenzimi) nga tatimi i shtyrë mbi fitimin	592,313	75,056	667,369
Më 31 Dhjetor 2017	<u>592,313</u>	<u>75,056</u>	<u>667,369</u>

16. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

17. Ngjarje të mëpasshme

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.